

Qeveria e Kosovës | Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Vlada Kosova | Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Government of Kosovo | Ministry of Economic Development

AKTIVITETET 2011

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Prishtinë, 2011



Misioni

Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës përgatit dhe zbaton politika, të cilat nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas, nxisin bashkëpunimin ekonomik për tërheqjen e investimeve të huaja, garantojnë konkurrencën dhe një treg të sigurt, sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike e minerare të vendit, sigurojnë zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit dhe teknologjisë informative, si dhe garantojnë efikasitet në administrimin e ndërmarrjeve publike.

Fjala hyrëse e ministrit

Të dashur qytetarë,



Viti 2011 mund të konsiderohet si një vit mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Themelimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dëshmoi edhe njëherë qartazi, angazhimin e Qeverisë së Kosovës për ta siguruar përmirësimin e standardit të jetesës së qytetarëve nëpërmjet hapave konkretë dhe politikave që garantojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike. Ky institucion do të jetë udhëheqës i politikave zhvillimore kombëtare, por edhe i strategjive zhvillimore në disa sektorë të rëndësishëm, si ai i Energjisë, i Minierave, si dhe i Postë-Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informativë.

Themelimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës implikoi ngritjen e strukturave të reja brenda këtij institucioni dhe reformimin e pjesëm të strukturave të barta nga institucionet ekzistuese. Gjithashtu, puna jonë në drejtim të fuqizimit të këtij institucioni u fokusua edhe në forcimin e marrëdhënieve me institucionet ndërkombëtare në fushën e ekonomisë, si dhe me institucionet e ngjashme

në vendet fqinje dhe partnerët tanë kyç në fushën e ekonomisë.

Ne i konsiderojmë reformat strukturore të ekonomisë dhe zhvillimin e sektorëve të Energjisë, Minerave dhe të Postë-Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative si motorin e domosdoshëm për ta garantuar rritjen ekonomike të parashikuar për vitet e ardhshme. Rrjedhimisht, puna jonë u fokusua në transformimin e ndërmarrjeve publike, duke e realizuar një progres të ndjeshëm drejt finalizimit të projekteve të privatizimit të PTK-së dhe Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, që do të sjellin një përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së shërbimit për qytetarët dhe afrimin e kapitalit privat në këta sektorë.

Gjithashtu, në fushën e energjisë është arritur progres drejt finalizimit të projektit të ndërtimit të Termocentralit 'Kosova e Re', kemi vazhduar me aktivitetet në fushën e energjisë së ripërtëritshme, ku si projekt madhor është projekti i HC

'Zhur'-it. Ndërsa, për sa i përket fushës së minierave, do të përmendja këtu hartimin e Strategjisë Minerare 2012-2025, e cila i hapë rrugë zhvillimit të sektorit dhe tërheqjes së kapitalit të huaj.

Gjatë vitit të ardhshëm, puna jonë do të fokusohet përdyshim në finalizimin e projekteve strategjike të lartpërmendura, si dhe implementimin e politikave zhvillimore në sektorët kyç. Jam plotësisht i bindur se hapat e ndërmarrë nga ne drejt modernizimit të strukturës së ekonomisë së Kosovës, janë në drejtimin e duhur dhe jo vetëm që do të garantojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike në vitet e ardhshme, por do të jenë edhe një shtysë e rëndësishme për integrimin e vendit tonë në familjen evropiane.

Sinqerisht,
Besim Beqaj,
Ministër



Ministri Besim Beqaj merr detyrën nga ministrja Pula

Prishtinë, 24 shkurt 2011 - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj ka pranuar detyrën nga Ministria e deritashme e Energjisë dhe Minierave, Justina Shiroka Pula, ministri e cila me riformatimin e Qeverisë do të inkorporohet në dikasterin e parë. Me këtë rast, ministrja Pula ka njoftuar ministrin Beqaj me stafin dhe punën e ministrisë gjatë këtyre tri viteve sa është drejtuar prej saj. Nga ana e tij, ministri Beqaj tha se është njoftuar me pu-

nën e madhe që është bërë në sektorin e energjisë dhe minierave duke theksuar do të bëjë maksimumin e mundshëm të çojë përpara projektet që janë në proces në këto fusha. Ministri Beqaj ka premtuar një bashkëpunim të ngushtë me stafin e ministrisë duke potencuar se Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe departamente të caktuara të Ministrisë së Ekonomisë së Financave do të fuzionohen në Ministrinë për Zhvillim Ekonomik.



Partneriteti Kosovë - Austri i shumanshëm

Prishtinë, 18 mars 2011 - Ministri i Zhvillimit Ekonomik Besim Beqaj gjatë takimit me ambasadorin austriak në Prishtinë, Johann Brieger, tha se partneriteti i Kosovës me Austrinë ka qenë partneriteti i të gjitha formave të bashkëpunimit si ekonomik, shkencor dhe politik. “Austria ka qenë dhe është shumë aktive në ekonomi. Mendoj që me ndryshimet e bëra kohëve të fundit dhe me legjislacionin që është duke u bërë së fundi, po hapen më shumë mundësi të angazhimit të ekonomisë austriake në Kosovë”, tha Beqaj.



Turqia e interesuar të vazhdojë bashkëpunimin me Kosovën

Prishtinë, 18 mars 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj ka marrë rikonfirmimin nga diplomatja turke në Kosovë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit politik dhe ekonomik mes Turqisë dhe Kosovës. Ministri Beqaj ka falënderuar ambasadoren turke Songul Ozan për kontributin e Turqisë dhe gatishmërinë për ta çuar më tej këtë bashkëpunim në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.



Holanda mbështet ripërtëritjen marrëveshjes tregtare Kosovë-BE

Prishtinë, 21 mars 2011 – Ambasadori i Mbretërisë së Holandës në Prishtinë, Robert Bosch ka premtuar ndihmën e Holandës për Kosovën sa i përket ripërtëritjes së marrëveshjes për preferencat tregtare në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Gjatë takimi që ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj zhvilloi me ambasadorin Bosch, u diskutua për bashkëpunimin bilateral mes dy vendeve me theks të veçantë në fushën e ekonomisë që mbulohet nga MZHE.

Privatizimi i PTK pjesë e reformës strukturore të ekonomisë

Prishtinë, 21 mars 2011 – Privatizimi i Postës dhe Telekomit të Kosovës është pjesë e reformës strukturore të ekonomisë së vendit ka thënë ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, në takim informues të Komisionit Qeveritar për Privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK), me përfaqësues të donatorëve, Fondit Monetar Ndërkombëtar, përfaqësuesit e ambasadeve të vendeve të Kuintit në Kosovë dhe ambasadorët e vendeve të investitorëve të interesuar për PTK-në. Me këtë rast, pjesëmarrësit në takim u informuan me progresin e bërë në lidhje me procesin e pjesëmarrjes së sektorit privat në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës.





Shqyrtohet punësimi sezonal i kosovarëve në Kuvajt

Prishtinë, 31 mars 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, ka theksuar interesimin e Republikës së Kosovës për bashkëpunim ndërshtetëror me Kuvajtin në implementimin e projekteve zhvillimore të përbashkëta – në fushën e ekonomisë, ndërsa shprehu bindjen se ky vend së shpejti do të ndërmarrë hapa konkretë drejt njohjes së parësisë së Kosovës. Këto komente ministri Beqaj i bëri gjatë takimit me Delegacionin e Grupit Ndërparlamentar të Miqësisë të Kuvajtit, të kryesuar nga Waleed Al-Tabtabae, kryetar i komisionit Ekzekutiv të Grupit, ku diskutuan mundësitë e bashkëpunimit bilateral. Me këtë rast, ministri Beqaj ka ngritur mundësinë e dërgimit të punëtorëve sezonal në Kuvajt nga fusha e shëndetësisë dhe inxhinierisë, që do të ndikonte në uljen e papunësisë në Kosovë.

Katër kompani në garë për privatizimin e KEDS-it

Prishtinë, 6 prill 2011 – Komiteti Qeveritar për privatizimin e Kompanisë së Distribuimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike – KEDS, ka mbajtur takimin e radhës me ç’rast janë shpallur kompanitë e para-kualifikuara në procesin e privatizimit të KEDS-it. Afati i fundit për dorëzimin e Aplikacioneve për Parakualifikim ka qenë 18 Mars 2011.





Kosova dhe Kroacia së shpejti me marrëveshje bashkëpunimi në ekonomi

Prishtinë, 6 prill 2011 – Republika e Kosovës së shpejti do ta formalizojë bashkëpunimin në fushën e ekonomisë me Republikën e Kroacisë, ka bërë të ditur ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, gjatë takimit që pati me Ambasadorin e Kroacisë në Prishtinë, Zoran Vodopija. Ministri Beqaj ka theksuar se ekziston një bashkëpunim i mirë i institucioneve të Kosovës me Kroacinë, i cili duhet të shkojë me tej, ndërsa vlerësoi se në këtë kuadër do të jetë edhe vizita e tij e paraparë për muajin maj të këtij viti në Kroaci, ku pritet të nënshkruhet edhe marrëveshje bashkëpunimi mes dy vendeve. Nga ana e tij, ambasadori Vodopija ka konfirmuar se ekziston vullneti politik nga dy vendet për avancimin e bashkëpunimit ekonomik, ndërsa ka potencuar interesimin e ndërmarrjeve kroate për të investuar në fushën e infrastrukturës dhe importin e pemëve.



Kosova dhe Kroacia nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit ekonomik

Zagreb, 13 maj 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe homologu i tij nga Kroacia, Ministri i Ekonomisë, Punës dhe Ndërmarrjes, Gjuro Popijaj nënshkruan në Zagreb një Memorandum Mirëkuptimi për bashkëpunim ekonomik në mes të dy vendeve.

Qëllimi i këtij Memorandumi është që të fuqizojë marrëdhëniet miqësore bilaterale në fushën e ekonomisë, me prioritet të veçantë të nxisë rritjen e qëndrueshme ekonomike në të dyja vendet përmes bashkëpunimit në sektorin e energjisë, thëngjillit, gazit natyral, burimeve të energjisë sërripërtërishme, eficientë e energjisë dhe asistencës reciproke në implementimin e projekteve dhe iniciativave në harmoni të plotë me politikat dhe strategjitë e të dyja shteteve në fushën e qeverisjes së ndërmarrjeve publike.

Ministri Beqaj në takimin me zëvendëskryeministrin për investime Domagoj Milosheviq bisedoi lidhur me mundësitë për bashkëpunim ekonomik në mes të dyja vendeve.



Bashkëpunimi ekonomik Kosovë - Shqipëri i avancuar

Prishtinë, 26 maj 2011 – Marrëdhëniet ekonomike Kosovë - Shqipëri, si edhe ato politike janë në nivel të avancuar, ndërsa nuk ka kurrfarë diskriminimi fiskal të Kosovës nga ana e Shqipërisë, ka theksuar Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj pas takimit me ambasadorin e Shqipërisë në Prishtinë, Islam Lauka. Ndërkaq, diplomati shqiptar ka mohuar se Tirana aplikon taksa diskriminuese ndaj produkteve të Kosovës.

Ministri Beqaj tha se me ambasadorin Lauka ka biseduar për bashkëpunimin ekonomik në mes të dy vendeve, për raportet e shkëlqyeshme, qoftë në aspektin politik qoftë në këndvështrimin ekonomik.

“Kosova dhe Shqipëria kanë një marrëdhënie të avancuar në aspektin e bashkëpunimit ekonomik të cilat ne nuk i kemi me vendet e tjera dhe në këtë drejtim falënderoj ambasadorin që ka mbështetur këtë bashkëpunim”, tha Beqaj.

Zvicra mbështet me 7 milionë franga sektorin e furnizimit me ujë

Prishtinë, 1 qershor 2010 – Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Konfederatën Zvicerane, e cila ka për qëllim dhënie të asistencës financiare për projektin e furnizimit me ujë në Kosovën Juglindore me vlerë prej 8 milionë e 400 mijë franga zvicerane.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, ndërsa në emër të Qeverisë zvicerane nga Ambasadori i Zvicrës në Prishtinë, Lukas Beglinger.

Projekti ka të bëjë me furnizimin me ujë për pjesën juglindore të Kosovës, për Komunën e Ferizajt dhe të Gjilanit, projekt i cili është me vlerë mbi 8 milionë franga zvicerane, nga të cilat mbi 7 milionë prej tyre financohen nga shteti zviceran, ndërsa mbi 1 milion euro bashkëfinancim i Qeverisë përmes MZHE-së.





MZHE prezantoi të arriturat e 100 ditëve

Prishtinë, 06 qershor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, ka paraqitur punën njëqind ditore të kësaj ministrie, ku ka veçuar punën në kompletimin e bazës ligjore, hartimin e dokumentit për prioritetet e zhvillimit ekonomik, monitorimin e ndërmarrjeve publike dhe realizimin e projekteve kapitale, ndërsa nuk ka lënë anash as bashkëpunimin rajonal dhe më gjerë. Duke u ndalë te plani i zhvillimit ekonomik, ministri ka theksuar rolin e rëndësishëm që MZHE ka pasur në hartimin e tij, plan i cili tashmë është veç para editimit final ku parashihen edhe projeksionet kohore të projekteve dhe njëkohësisht do të merret edhe me efektet e prishme të tyre. “Kemi konsideruar që një dokument i tillë të mos mbetet dokument në listë dëshirash, por dokument i cili parasheh projektet konkrete të secilit resor qeveritar dhe njëkohësisht të shohim se cilat janë efektet të cilat mund t’i presim nga ky dokument”, ka thënë ai.

Ministri Beqaj tha se gjatë këtij tremujori MZHE është fokusuar në ristrukturimin e saj dhe deri tani është përmbyllur baza legjislative, bashkëpunimi dhe marrëveshjet me ministrinë tjera nga të cilat janë batur njësitë edhe me pjesët buxhetore, por edhe me pjesën e stafit që tashmë është miratuar.



Mbi 370 mijë euro për eficiencyn e energjisë

Prishtinë, 9 qershor 2011 – Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale të Gjermanisë për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në fusha të ndryshme, u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit në mes të MZHE-së dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ, i cili do të jetë bazë për lidhjen e kontratave me qëllim të bashkëfinancimit të projektit për ndriçim eficient për objektet publike në nivele komunale. Projekti të cilin e nënshkruan Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, Udhëheqësja e Projektit, Gabriele Becker dhe kryetarët e pesë komunave është në harmoni me standardet evropiane për eficiencyn e energjisë, si dhe në harmoni të plotë me Planin Nacional për Eficiencyn e Energjisë, me të cilin është paraparë që deri në vitin 2018 të rrisim eficiencyn e energjisë në masën prej 9%.



Ministri Beqaj vizitoi panairin “Prishtina 2011”

Prishtinë, 9 qershor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj i shoqëruar nga kryetari Odës Ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka vizituar Panairin e Përgjithshëm Ndërkombëtar “Prishtina 2011”, në të cilin po marrin pjesë 100 kompani nga Kosova, rajoni dhe më gjerë. Në kuadër të vizitës, ministri Beqaj ka biseduar me pjesëmarrës nga të cilët është njoftuar me punën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen këto biznese gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre. Beqaj ka thënë me këtë rast se Qeveria e sheh komunitetin e biznesit si partner të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj është shumë e interesuar që të krijojë një ambient të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat.



Beqaj: Kosova do t’i përmbushë obligimet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë

Vjenë, 30 qershor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, ka deklaruar se Kosova do t’i përmbushë obligimet nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Në konferencën “Dita e Institucioneve të Kosovës në Komunitetin e Energjisë”, e cila është organizuar në Vjenë nga ana e MZHE-së dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (TKE), ministri Beqaj ka theksuar se Republika e Kosovës është e përkushtuar maksimalisht që ta miratojë kornizën ligjore në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së, i cili është parakusht esencial me qëllim të realizimit të obligimeve të cilat dalin nga Traktati. Me këtë rast ministri Beqaj ka informuar Sekretariatit lidhur me rrjedhën e implementimit të projekteve prioritare, të cilat ndërlidhen me sektorin e energjisë, me një theks të veçantë në arritjen e objektivave në fushën e eficiencys së energjisë dhe burimeve të ripërritshme.

Banka Botërore do të vazhdojë t'i përkrah projektet e energjisë në Kosovë

Prishtinë, 7 korrik 2011 – Banka Botërore do të vazhdojë t'i përkrah projektet në lëmin e energjisë në Kosovë, u tha në takim të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe drejtorit ekzekutiv të Bankës Botërore, Konstatin Huber.

Ministri Beqaj pasi falënderoi për përkrahjen e deritashme, e informoi drejtorin Huber lidhur me projektet në lëmin e energjisë, me theks të veçantë në projektin 'Kosova e Re'.

Gjatë takimit u bisedua lidhur me ndihmën dhe përkrahjen e Bankës Botërore projekteve në lëmin e energjisë, duke përfshirë edhe projektin e Termocentralit 'Kosova e Re' dhe garancionet të cilat BB mund t'i ketë në dispozicion lidhur me këtë projekt.

Temë e bisedës ishin edhe hartimi i një numri të studimeve lidhur me energjinë e ripërtëritshme në Kosovë dhe ndihmën të cilën në këtë drejtim do të mund ta japë BB-ja.



Fillon punën Komiteti Drejtues i Projektit "Kosova e Re" me përbërje të rifreskuar

Prishtinë, 7 korrik 2011 – Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr. 08/17 mbi ri-konfigurimin e strukturës së Komitetit Drejtues të Projektit (KDP) për ndërtimin e termocentralit të ri dhe pas marrjes së pëlqimit nga Banka Botërore për strukturën e re, më 6 korrik 2011 është mbajtur takimi i parë i komitetit me përbërje të re.

KDP-së përbëhet nga MZHE (Kryesues), dhe anëtarët nga MF, MMPH, MPMS, MTI, ZKM, ZRRE, KPMM dhe vëzhgues nga KEK, KOSTT, Banka Botërore, KE, USAID, KfW, ZCN.





Beqaj: Qeveria po krijon bazën për zhvillimin e Trepçës

Prishtinë, 04 gusht 2011 – Ndërmarrja Trepça është një burim i jashtëzakonshëm natyror, një thesuri e cila Kosovën e ka bërë të njihet ndërkombëtarisht, e cila në të ardhmen me përkushtimin institucional dhe të menaxhmentit do të jetë një nga minierat më të fuqishme në nivel të rajonit, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

Këto komente Beqaj i bëri gjatë vizitës në horizontin e 10 të minierës së Trepçës, ku shoqërohej nga kryetari i KK të Mitrovicës, Avni Kastrati dhe drejtori menaxhues i Trepçës, Ferat Shala, si dhe stafi i minierës.

Me këtë rast, ministri Beqaj tha se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që të krijojë strategji të qartë minerare dhe normalisht të kemi legjislacion, i cili mundëson zhvillimin e Trepçës si një kompleks jashtëzakonisht i rëndësishëm.



Mallrat serbe po zëvendësohen pa probleme

Gjilan, 10 gusht 2011 – Procesi i zëvendësimit të mallrave me origjinë serbe me mallra tjera po zhvillohet pa ndonjë problem, ndërsa vendimi i Qeverisë për reciprocitet me Serbinë është duke u zbatuar në mënyrë strikte, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj gjatë vizitës në Komunën e Gjilanit.

Me këtë rast, ministri Beqaj me bashkëpunëtorë ka takuar kryetarin e Komunës së Gjilanit, Qemal Mustafa, ka vizituar Ujësjiellësin Rajonal dhe kompaninë private për prodhimin e pajisjeve të metalit “Megi”.

Ministri Beqaj tha se qëllim i kësaj vizite në Gjilan ishte të njihet me konceptet zhvillimore të kësaj komune në një moment jashtëzakonisht të rëndësishëm pas vendimit të qeverisë për vënien e reciprocitetit për t’u përkujdesur për furnizimin me mallrat e domosdoshme, kualitative dhe për të shikuar eventualisht ndonjë tendencë për keqpërdorim të situatës që mund të na rrjedhë, qoftë nga ndërmarrjet vendore, por edhe në nivel rajonal.



Gjermania fuqishëm përkrah Kosovën

Prishtinë, 25 gusht 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj ka pritur ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë, Ernst Reichel, i cili me këtë rast përsëriti përcaktimin e vendit të tij për ta përkrahur Kosovën në të gjitha fushat.

Ministri Beqaj theksoi se Kosova i është shumë mirënjohëse Gjermanisë për rolin dhe ndihmën e saj në zhvillimin e proceseve demokratike në vend dhe në lëmin e zhvillimit ekonomik.

Me këtë rast ai theksoi se në Kosovë është mirëpritur qasja shumë e rëndësishme e shtetit gjerman lidhur me proceset e mëtejme në Kosovë dhe posaçërisht deklarata e kancelares Angela Merkel lidhur me mënyrën e zgjidhjes së problemeve, të cilat në marrëdhënie me Kosovën i shkakton Serbia.

Beqaj: Masat e reciprocitetit kanë dhënë efekte pozitive

Pejë, 18 gusht 2011 – Masat e reciprocitetit kanë dhënë efekte jashtëzakonisht pozitive, sidomos për Komunën e Pejës, ngase ndërmarrjet prodhuese kanë rritje të prodhimit dhe konsumatorët janë duke konsumuar produkte vendore, të cilat kanë cilësi, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

Këto komente ministri Beqaj i bëri gjatë vizitës në Komunën e Pejës, ku u takua me kreun e Komunës, Ali Berisha dhe zhvilloi vizita në Ujësjellësin Regional “Hidro Drini” dhe kompaninë prodhuese “Birra Peja”.

Me këtë rast, ministri Beqaj ka theksuar se gjatë takimit me kreun e Komunës së Pejës ka diskutuar për masat e reciprocitetit në këtë komunë dhe për efektin që kanë pasur këto masa në ekonominë vendore, por edhe për qytetarët e komunës së Pejës.



Qeveria po shqyrton lehtësirat fiskale për bizneset

Gjakovë, 26 gusht 2011 – Ministria e Zhvillimit Ekonomik, së bashku me Ministrinë e Financave janë duke shqyrtuar një pako fiskale me të cilën synohet krijimi i lehtësirave fiskale për bizneset që krijojnë vende të reja pune dhe kjo do të jetë një stimulim për biznesin vendor, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

Këto komente, Beqaj i bëri gjatë vizitës në Komunën e Gjakovës, ku mori pjesë në inaugurimin e Fabrikës për grumbullimin dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve “Hosa” në Rogovë të Gjakovës, ku i pranishëm ishte edhe ministri i Bujqësisë, Blerand Stavileci, sekretari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, përfaqësues të USAID-it, zyrtarë lokalë dhe afaristë.

Kosova përfaqësohet si shtet në takimin për energjinë në Poloni

Vrocllav/Poloni, 20 shtator 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, gjatë konferencës joformale të ministrave të energjisë të vendeve të Bashkimit Evropian në Vrocllav të Polonisë në takimet e shumta ka prezantuar orientimet strategjike të Kosovës në lëmin e energjisë. Për shkak të ftesës që i është bërë Kosovës si shtet nga ana e Polonisë, si Kryesuese e radhës e BE-së, në takim nuk kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Serbisë. Në takim mori pjesë edhe komisionari i BE-së për energji, Ginter Etinger. Beqaj në takimet që i kishte në kuadër të diskutimit rreth zhvillimit të infrastrukturës së përbashkët Evropiane, theksoi se objektivat kryesore të strategjisë së energjisë janë që të arrihet pavarësi dhe furnizim i mjaftueshëm me energji elektrike, që tregu i energjisë të jetë i vetqëndrueshëm, duke eliminuar nevojën për subvencione nga Qeveria dhe duke mundësuar që tarifat të jenë të përballueshme për qytetarët e Kosovës.





Beqaj: Synimi i Qeverisë, zhvillimi i sektorit privat

Prishtinë, 27 shtator 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj ka vlerësuar se ekonomia e Republikës së Kosovës ka shënuar hapa pozitivë, por problemet ekonomike globale kanë pasur efektin e tyre edhe në ekonominë e vendit, megjithatë projeksionet për rritjen ekonomike prej 7-8 për qind për vitin e ardhshëm janë mjaft shpresëdhënëse. Këto komente ministri Beqaj i bëri sot gjatë konferencës njëditore “Mundësitë dhe sfidat e zhvillimit ekonomik dhe fuqizimi i sektorit privat”, që u organizua nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Aleancën Kosovare të Biznesit, ku u diskutuan mundësitë e zhvillimit ekonomik dhe rolin e sektorit privat. Me këtë rast, Beqaj ka theksuar se synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është zhvillimi i sektorit privat dhe kjo nuk është një slogan, por është një punë konkrete ku të gjitha ministratë që kanë marrë pjesë në hartimin e programit ekonomik janë involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e këtij objekti.



Kosova ka shënuar progres në implementimin e obligimeve nga TKE

Prishtinë, 6 tetor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, në takimin e 9-të të Këshillit Ministror të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), i cili u mbajt në Kishinjev të Moldavisë, ka potencuar se Republika e Kosovës ka realizuar progres të jashtëzakonshëm në implementimin e obligimeve të cilat dalin nga TKE dhe në procesin e integritimit të Bashkimit Evropian. Ministri Beqaj theksoi se Republika e Kosovës ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme në fushën e reformimit të sektorit të energjisë. Në këtë drejtim ai i ka informuar pjesëmarrësit se Kuvendi i Kosovës i ka miratuar ligjet bazë në fushën e energjisë, siç janë Ligji për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe Ligji për Efiçencën e Energjisë, dhe aktet e tjera nënligjore të cilat janë në proces të implementimit.

Beqaj: Opinioni i TKE-së, fitore ligjore për Kosovën

Prishtinë, 12 tetor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, e ka quajtur moment të rëndësishëm opinionin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, me të cilin konstatohet se Serbia është shkelës i Rregullave të Traktatit në raport me Kosovën, ku i kërkohet që brenda dy muajsh të korrigojë shkeljet e konstatuara.

Këto komente, Ministri Beqaj i bëri sot gjatë një konference të për-bashkët me drejtorin menaxhues të KOSTT-it, Fadil Ismajli, ku dhanë detaje të këtij opinionin dhe rëndësinë e tij, ndërsa u vu në dukje se Republika e Kosovës ka marrë pozicionin e duhur në kuadër të TKE-së. Me këtë rast, ministri Beqaj nënvizoi se përveç anës financiare dhe teknike, ky opinion i Sekretariatit të TKE-së ka një rëndësi të veçantë ngase me të Republika e Kosovës shënon një fitore ligjore në këtë mekanizëm, derisa identifikohet qartë se kush është shkelësi i Traktatit.

Beqaj: Procesi i privatizimit të PTK-së nis nga fillimi

Prishtinë, 17 tetor 2011 – Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-së ka marrë vendim që shpall të mbyllur procesin e privatizimit të PTK-së dhe të nis përgatitjet për një proces të ri të privatizimit të kësaj kompanie, i cili do të realizohet në bazë të orientimeve strategjike që ka Qeveria, ka deklaruar Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj. Këto komente ministri Beqaj i bëri sot gjatë një konference për media ku bëri publike vendimin e KQP-së, duke vlerësuar se vendimi është konform interesave të qytetarëve dhe interesave ekonomike të vendit. “Gjatë kësaj kohe, Qeveria i ka kryer të gjitha obligimet e veta. Ka bërë raportin e ekzaminimit financiar e ligjor, ekzaminim teknik dhe të biznesit, ka bërë raport për çështjet rregullatore në Kosovë, ka marrë vendim për ndarjen e Postës, e cila në mënyrë specifike përcakton se cilat asete i mbesin Postës dhe cilat investitorëve privatë”, tha Beqaj.





Marrëdhëniet ekonomike Kosovë-Maqedoni kanë shënuar zhvillime pozitive

Prishtinë, 14 tetor 2011 – Marrëdhëniet Ekonomike mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë kanë shënuar zhvillime pozitive dhe kjo pasqyrohet edhe me rritjen e eksporteve të Kosovës në këtë vend fqinj për 100 për qind, ka deklaruar Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, pas takimit me homologun nga Maqedonia, Valon Saraçini.

Gjatë takimit mes dy ministrave që u mbajt para nisjes së punimeve të Forumit Biznesor Kosovë-Maqedoni, është diskutuar mundësia e avancimit të bashkëpunimit ekonomik në të gjitha fushat në interes të dy vendeve.

Ministri Beqaj tha se Kosova dhe Maqedonia kanë marrëveshje për bashkëpunim ekonomik dhe konform kësaj marrëveshjeje, fillon punimet Komiteti i përbashkët ndërqeveritar për përcaktimin e mundësive dhe potencialeve të bashkëpunimit ekonomik në mes dy shteteve.



Ministri Beqaj vizitoi fabrikën e ujit “Kllokot”

Prishtinë, 20 tetor 2011 – Qeveria e Republikës së Kosovës është duke përmirësuar politikat fiskale në favor të biznesit vendor me synim të heqjes së të gjitha barrierave potenciale për zhvillimin e sektorit privat, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, gjatë vizitës në fabrikën e prodhimit të ujit mineral “Kllokot” në Kllokot, ndërsa kërkoi qasje më institucionale nga ana e bizneseve.

Gjatë takimit me stafin menaxhues të kësaj fabrike, ministri Beqaj ka ofruar mbështetjen e Qeverisë për biznesin, duke theksuar se për këtë qëllim është ndërmarrë një iniciativë për krijimin e Qendrës për Eksport, ku bizneset do të marrin të gjitha informacionet e nevojshme për mënyrën e eksportimit të produkteve të tyre në tregjet e jashtme.



Beqaj: Politikat e Qeverisë favorizojnë biznesin vendor

Prishtinë, 20 tetor 2011 – Qeveria e Kosovës do të vazhdojë me investimet e saj kapitale, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në zhvillimin e ndërmarrjeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj.

Këto komente Beqaj i bëri me rastin e inaugurimit të linjës së prodhimit të mburojave metalike të rrugëve në fabrikën Vinex në Viti, ku të pranishëm ishin edhe zv.kryeministrja Mimoza Kusari-Lila, kreu i Odës Ekonomike, Safet Gërxhaliu, kryetari i Komunës, Nexhmedin Arifi dhe përfaqësues të USAID-it dhe GIZ-it.

Beqaj tha se investimi në fabrika të tilla siç është “Vinex” çon drejt realizimit të përkushtimit të Qeverisë së Kosovës për të krijuar një ambient më të mirë për sektorin privat, e veçanërisht për prodhuesit.



Ministri Beqaj priti një delegacion të lartë nga Malta

Prishtinë, 27 tetor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, priti sot në takim një delegacion të lartë nga Malta, të kryesuar nga Guiseppe Madia, ministër i shëndetësisë, të cilët i njoftoi lidhur me prioritetet e zhvillimit ekonomik të vendit. Gjatë takimit delegacioni i lartë nga ky shtet në të cilin ishin edhe ministri i Financave, Andrea Frattini dhe ministri i Thesarit, Geattano Mario Maza, u informua se Qeveria e Republikës së Kosovës është e përcaktuar për ekonomi të tregut të lirë dhe integrimin politik ekonomik dhe teknologjik të vendit në strukturat euroatlantike. Qeveria e Kosovës është e orientuar për rritjen e konkurrueshmërisë, fuqizimin e sektorit privat, rritjen e punësimit, përmirësimin e imazhit të Kosovës për investime dhe për ambient të sigurt dhe stabil për të bërë biznes, tha ministri Beqaj.

Beqaj: Kosova mbështet fuqishëm implementimin e agjendës e SEE plus

Tiranë, 7 nëntor 2011 – Qeveria e Republikës së Kosovës e mbështet fuqishëm Iniciativën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal për Evropën Juglindore Elektronike dhe është e përkushtuar se plani i veprimit të eSEE Agjenda Plus do të implementohet në Kosovë, në bazë të afateve të rishikuara, ka deklaruar Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Besim Beqaj, në takimin e organizuar në Tiranë nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal për Evropën Juglindore Elektronike.

Në këtë takim të nivelit të lartë për zhvillimin e shoqërisë teknologjike, ku morën pjesë ministrat nga rajoni që mbulojnë fushën e Teknologjisë Informative, i pranishëm ishte edhe kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, përfaqësues të KE-së, UNDP-së, drejtues të Zyrës së Zhvillimit të Telekomunikacionit të ITU-së, etj, ndërsa Serbia e braktisi takimin kur ministri Beqaj mori fjalën.



Beqaj: Ndrëçimi eficient, pjesë e Planit Kombëtar të EE-së

Prishtinë, 10 nëntor 2011– Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, i shoqëruar nga kryetari i Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa, në mënyrë simbolike kanë inauguruar projektin e ndriçimit publik eficient, përmes instalimit të poçaveeficiente në rrugën “Ilir Konushevi” në kryeqytet.

Me këtë rast, Ministri Beqaj ka shprehur kënaqësinë që me kryetarin e Prishtinës po e promovojnë një projekt të ri që ka të bëjë me eficiencën e energjisë, e i cili zhvillohet në kuadër të Planit Kombëtar për Eficiencën e Energjisë.

“Janë plane të përbashkëta me komunat e Republikës së Kosovës të përkrahura edhe nga GIZ. MZHE edhe në komuna tjera është duke marrë masa për ndriçim publik me poça eficientë, të cilët ndihmojnë edhe në kursimin e energjisë elektrike, kanë jetëgjatësi më të madhe dhe njëherësh u ofrojnë qytetarëve një kualitet më të mirë të ndriçimit”, tha Beqaj.





Ministri Beqaj takoi Drejtoreshën e Bankës Botërore për Evropën Juglindore, Armitage

Prishtinë, 10 nëntor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, ka zhvilluar një takim me një delegacion të Bankës Botërore, të kryesuar nga Drejtoresha e Bankës Botërore për Evropën Juglindore, Jane Armitage.

Në takim është diskutuar për strategjinë e re katërvjeçare të Bankës Botërore për Kosovën, përfshirë këtu edhe përkrahjen e mëtutjeshme të Bankës Botërore për sektorin e energjisë.

Armitage ka konfirmuar përkushtimin e Bankës Botërore për vazhdimin e përkrahjes për zhvillimin e Kosovës. Ajo ka informuar Ministrin se përgatitjet për hartimin e strategjisë së re të Bankës Botërore për Kosovë për periudhën 2012-2015 kanë filluar.



Ministri Beqaj takoi kryeministrin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan

Stamboll, 16 nëntor 2011 – Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, ka takuar në Stamboll kryeministrin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan me të cilin ka bisedua rreth gjendjes ekonomike në dy vendet dhe proceseve të rëndësishme nëpër të cilat është duke kaluar Kosova.

Gjatë pjesëmarrjes në Forumin Ekonomik dhe Energjisë të Detit të Zi, ministri Beqaj u takua me Zv. Kryeministrin e Turqisë të ngarkuar me ekonomi, Ali Babacan ku janë diskutuar zhvillimet ekonomike dhe janë shqyrtuar mundësitë e bashkëpunimit bilateral në sferën e ekonomisë mes të dy shteteve.

Me këtë rast, Beqaj ka shpallur projektet konkrete të cilat janë duke u realizuar në fushën e energjisë, minierave, telekomunikacionit, infrastrukturës rrugore, turizmit dhe gjithashtu ka njoftuar Babacan rreth potencialeve për investime nga ana e ndërmarrjeve turke në Republikën e Kosovës.

Ministri Beqaj është takuar edhe me homologun e tij, Taner Yıldız – ministër për Energji dhe Resurse Natyrore. Gjatë këtij takimi është diskutuar rreth projekteve në fushën e energjisë, me ç'rast janë ftuar ndërmarrjet turke për të konkurruar fuqishëm në këto procese të rëndësishme.



Mbi 2.7 milionë euro për furnizim dhe cilësi të ujit në zonat rurale

Prishtinë, 2 dhjetor 2011 – Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka nënshkruar Marrëveshje bashkëfinansimi me Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim për projektin “Programi i Mbështetjes së Ujit dhe Sanitacionit në zonat rurale, faza IV” që do të implementohet në Kosovën Juglindore.

Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe drejtori i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovës, Markus Baechler, ndërsa parashihet që Programi i Mbështetjes së Ujit dhe Sanitacionit në zonat rurale të financohet me 2 milionë e 250 mijë CHF nga Qeveria Zvicerane dhe 940 mijë euro nga Qeveria e Kosovës.



Beqaj: Llamkos, një shembull për investitorët e huaj

Prishtinë, 15 dhjetor 2011 - Aty ku ka fabrika, ka zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale, ka deklaruar ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj gjatë vizitës në kompaninë e riprivatizuar Llamkos-Galva Steel në Vushtrri, me ç’rast ka ritheksuar mbështetjen e Qeverisë për zhvillimin e sektorit privat. Ministri Beqaj u shpreh se është i inkurajuar nga drejtuesit e kompanisë, të cilët kanë bërë të ditur se në procesin e privatizimit të Llamkos përmes likudimit procesi ka shkuar mbi 7 milionë euro dhe tanimë kompania ka rreth 350 të punësuar. “Kjo është ajo çka i duhet ekonomisë së Kosovës. Kjo është në harmoni të plotë me vizionin për zhvillim ekonomik. Kemi thënë që sektori privat duhet të jetë bartës i zhvillimit ekonomik dhe dinamika e sektorit privat do ta diktojë pastaj edhe dinamikën e sektorëve të tjerë dhe natyrisht në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në rritjen e atraktivitetit të Kosovës”, tha Beqaj.

Beqaj: Plotësimi i kornizës legjislative arritja kryesore e 2011-s

Prishtinë, 27 dhjetor 2011 – Plotësimi i kornizës legjislative në fushën e ekonomisë, opinionin pozitiv i Traktatit të Komunitetit të Energjisë lidhur me ankesën e KOSTT dhe realizimi i 96 për qind i parashikimeve buxhetore të MZHE-së, janë vlerësuar ndër sukseset kryesore të ministrisë për vitin 2011 nga ana e ministrit Besim Beqaj.

Në konferencën përmbyllëse për këtë vit, ministri Beqaj ka numëruar të arriturat e MZHE-së, stadin e projekteve që janë në realizim dhe prioritet për vitin 2012.

Duke u ndalur tek sukseset, ai tha se MZHE ka plotësuar tërë agjendën e vet legjislative për vitin 2011, ngase janë aprovuar: Ligji për Eficiencë të Energjisë; Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës; Ligji për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre; ka kaluar në Qeveri Projektligji për Shërbimet e Shoqërisë Informatike; pritet të aprovohen, Projektligji për Komunikime Elektronike; dhe Ligji i plotësuar për Ndërmarrjet Publike.

Gjithashtu, janë finalizuar edhe aktet nënligjore si Strategjia Minerare 2012-2025, Strategjia e Ngrohjes 2011 – 2018, Muzeu, Renta Minerare, Hulumtimet Gjeologjike, Balancat e Energjisë etj.

Sa i përket projekteve, PTK, KEDS dhe TC ‘Kosova e Re’, Beqaj tha se me disa përjashtime, ato po shkojnë sipas planifikimeve, ndërsa nënvizoi se qëllimi i Qeverisë është menaxhimi sa më i mirë me asetet publike.

“KQP ka marrë vendim për ta rifilluar procesin nga pika 0. Duke pas për qëllim rritjen e vlerës së aksioneve – KQP ka vendosur të ndërmarr disa reforma (ulja e shpenzimeve operative etj.). Në Nëntor është proceduar me ndarjen e njësisë Posta dhe poashtu, është shpallur njoftimi për shprehje të interesit për Këshilltar të Transaksionit – i

cili do të përmbyllet në Janar 2012”, tha Beqaj.

Kreu i MZHE-së vlerësoi se projekti për privatizimin e KEDS-it ka vazhduar me një dinamikë të jashtëzakonshme, është bërë shpallja e ofertës dhe pritet që në muajin mars të shpallet fituesi për distribucionin.

“Projekti i TC ‘Kosova e Re’, ka pasur disa vonesa që kanë të bëjnë me Bankën Botërore dhe pas harmonizimit me këtë mekanizëm MZHE në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ka vendosur që këshilltarin e transaksionit për TC ‘Kosova e Re’ ta përzgjedh vet, me ç’rast janë kursye rreth 6 milionë euro”, tha ai dhe shtoi se orientimet e Qeverisë janë që ky projekt të bëhet në harmoni të plotë me BE dhe BB.

Më tej ministri nënvizoi se MZHE ka vazhduar procesin e Monitorimit të 15 Ndërmarrjeve Publike dhe ushtrimin e rolit këshillëdhënës lidhur me respektimin e LNP, kodin e etikës dhe qeverisjes korporatave.

Beqaj me këtë rast ka përmendur edhe pjesëmarrjen dhe organizimin e takimeve të nivelit të lartë, ku hyjnë forumet biznesore, takimet në kuadër të Komunitetit të Energjisë, takimin e BERZH-it dhe takimet dypalëshe me homologë dhe liderë të shteteve të ndryshme.

Sa i përket prioriteteve për vitin 2012, ministri ka renditur; vazhdimin e implementimit të projekteve (PTK, KEDS, TC ‘Kosova e Re’); Organizimi i aktiviteteve me qëllim të promovimit të investimeve në fushën e Energjisë, Minierave, Telekomunikacionit dhe IT-sëetj; Fuqizimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit me komunitetin e biznesit me qëllim të krijimit të politikave, strategjive të cilat do të ndikojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat.





Ministri Beqaj priti kreun e Odës Ekonomike Italo-Kosovare

Prishtinë, 28 dhjetor 2011 - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj priti kryetarin e Odës Ekonomike Italo-Kosovare, Hamdi Muhameti, ku fokusi i bisedës u përqendrua në mundësitë e investimeve në Republikën e Kosovës nga ana e biznesit italian.

Më këtë rast, Ministri Beqaj ka informuar përfaqësuesit e Odës Ekonomike Italo-Kosovare për mundësitë e investimeve në fushat që mbulon Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përfshirë potencialet në fushën e energjisë së ripërtëritshme.

Nga ana e tij, kreu i Odës Ekonomike Italo-Kosovare, Hamdi Mehmeti ka njoftuar ministrin Beqaj për interesimin e investitorëve italianë për të investuar në Kosovë, respektivisht në prodhimin e energjisë së ripërtëritshme.

Propozohet forum biznesor Kosovë-EBA

Prishtinë, 20 dhjetor 2011 - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj ka pritur Ambasadorin e Emirateve të Bashkuara Arabe në Ankara, jorezidentpër Kosovë, Khalid Khalifa Al Mualla, me të cilin diskutoi rreth mundësive të intensifikimit të bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve. Me këtë rast, ministri Beqaj ka shpalosur prioritetet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe ka njohur delegacionin e EBA-së me projektet që janë duke u realizuar dhe ato që pritet të realizohen në të ardhmen, kryesisht në sektorët e energjisë, minierave dhe telekomunikacionit. Ministri Beqaj, e njoftoi ambasadorin e EBA-së edhe me potencialet e Kosovës në fushën e përpunimit të ushqimit, duke nënvizuar se ende vendi importon një pjesë të madhe të produkteve ushqimore dhe ftoi kompanitë e EBA-së të investojnë në këtë sektor, i bindur se do gjejnë një treg të përshtatshëm.





Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Zyra për Komunikim Publik

Sheshi "Nëna Terezë", 10 000 Prishtinë, Kosovë.

Tel: + 381 200 215 05; Fax: 200 215 02;

Web: <http://mzhe.rks-gov.net>

